



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1416/Prot.
2

Tiranë, më 21/12/2016

REKOMANDIM

Nr. 38 datë 21/12 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë". Zyra e Komisionerit ka kryer hetim administrativ në ngarkim të kontrolluesit "Europe Agency" sh.p.k. Tiranë, në përfundim të të cilit,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 261, datë 07.12.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 14.12.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit "Europe Agency" sh.p.k. Tiranë, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, masat për sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit, "Europe Agency" sh.p.k. Tiranë.

Në datë 14.12.2016, grupi i kontrollit komunikoi me përfaqësuesit e kontrolluesit, mbi detyrimin për zbatim të Urdhrit Nr.261, datë 07.12.2016 të Komisionerit, të cilët ishin njohur me të. Kontrolluesi, "Europe Agency" sh.p.k. Tiranë, sipas licencës nga QKB është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar si e tillë, në 15.04.2016, me objekt të aktivitetit: shërbime ndërmjetësimi në tregun e punës/ose formimit profesional.

Kontrolluesi i përfaqësuar nga administratori i saj, në zbatim të kërkesave të Urdhrit Nr.261, datë 07.12.2016 të Komisionerit bashkëpunoi me grupin e kontrollit për finalizimin e këtij urdhri.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi e ka kryer "Njoftimin" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21-22 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, më datë 15/12/2016.
2. Kontrolluesi ka rregullore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi aplikon për punëmarrësit "Deklaratën e Konfidencialitetit".
4. Konstatohet se në portalin e kontrolluesit www.europeagency.al, aplikantët informohen në rubrikën e aplikimit; mbi përpunimin e të dhënave dhe njohjen me të drejtat sipas Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Koha e ruajtjes së të dhënave imazhe-video është në përputhje me Udhëzimin Nr. 3 të Komisionerit dhe tabelat informuese janë konform standartit të këtij udhëzimi. Pavarësisht masave të marra për mbledhjen e të dhënave personale, kontrolluesi monitoronte me kamera vëzhguese ambientet e brendshme të zyrave.

Faktet e mësipërme sipas pikës 5 të konstatimeve, përbëjnë shkelje administrative:

Të Udhëzimit Nr.3 datë 05.03.2010 mbi "Përpunimin e të Dhënave Personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit, vlerëson faktin që kontrolluesi dhe pse i sapo hyrë në tregun e ndërmjetësimit, ka rregulla të qarta dhe rigorozë për mbrojtjen e të dhënave personale. Përfaqësuesi i kontrolluesit i pyetur nga grupi i kontrollit për faktin e zyrave të monitoruara nga kamerat e vëzhgimit arsyei si vijon:

"Në natyrën e punës së "Europe Agency" sh.p.k. Tiranë, procedurat e rekrutimit, duhen të jenë transparente si ato për punësimin apo formimin profesional. Në çdo zyrë, ku monitorohen intervistuesit aplikantë e për pasojë dhe punonjësit tanë të cilët intervistojnë, janë vendosur tabelat e informimit si dhe ju i konstatuat. Kemi patur raste të shumta ku aplikantët kanë shfaqur pretendime, dhe regjistrimet kanë nxjerrë në pah paanësinë dhe rregullsinë e procedurës së intervistimit nga ana jonë".

Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:

- Njoftimi pranë Zyrës së Komisionerit.
- Rregullore e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Deklaratë konfidencialiteti.
- Përshkrim pune (menaxher rekrutimi).
- Autorizim për punonjësit e Europe Agency sh.p.k., për aksesin në të dhëna personale dhe sisteme.

- Marrëveshje rekrutimi me palë të treta për punësimin e subjekteve të të dhënave.
- Procesverbal për dokumentat e dorëzuara të aplikantëve.
- Formular aplikimi, termat dhe kushtet e punësimit në Emiratet e Bashkuara Arabe.
- Lista e miratuar për publikimin e pozicioneve të punësimit jashtë vendit për periudhën 2016-2017 të agjencisë ndërkombëtare të punësimit, miratuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
- Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me Europe Agency sh.p.k.
- Akt themelimi i Europe Agency sh.p.k.
- Kontratë individuale pune për punonjësit e “Europe Agency” sh.p.k.
- Certifikatë regjistrimi QKB.
- Ekstrakt i Regjistrimit tregtar.
- Licencë për ushtrim aktiviteti.
- Fotografi të ambienteve të mbikëqyrura më sistemin e video-vëzhgimit (CCTV).
- Printim nga ndërfaqja e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).
- Printime nga ndërfaqja www.europeagency.al.

Zyra e Komisionerit, në përputhje me Udhëzimin Nr.3 datë 05.03.2010 mbi “Përpunimin e të Dhënave Personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, në tërësi por dhe specifikisht, pika 4, gërma “b”, i cili shprehet:

“b) Qëllimi i regjistrimit duhet të specifikohet qartë dhe të jetë në përputhje me interesat ligjore të kontrolluesit. Regjistrimet mund të përdoren vetëm për hetimin e një ngjarje që ka sjellë dëmtimin e këtyre interesave të mbrojtura me ligj. Legjitimiteti i përdorimit të të dhënave personale të regjistruara për qëllime të tjera duhet të jetë i kufizuar vetëm për një interes të rëndësishëm publik.”

çmon, rishikimin e mënyrës së vërtetimit mbi rregullsinë e procesit të intervistimit me aplikantët për punësim apo formim profesional. Nëse intervistimi i aplikantëve është qëllimi parësor i monitorimit, një qëllim i dytë është dhe monitorimi i punëmarrësve nga punëdhënësi.

Mbajtja e një proces verbali midis palëve në këtë proces, ose kryerja e regjistrimit me kamera vëzhguese vetëm për procesin e intervistimit, pa bërë pjesë të këtyre regjistrimeve kohën e punës të punëmarrësve, janë zgjidhjet alternative.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe në kuadër të gjetjeve të hasura pranë këtij kontrolluesi,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, "Europe Agency" sh.p.k. Tiranë, brenda një periudhe 10 (dhjetë) ditore nga dalja e këtij akti, të finalizojë procesin e monitorimit me kamerat vëzhguese gjatë intervistimeve, në përputhje Udhëzimin Nr.3 datë 05.03.2010 mbi "Përpunimin e të Dhënave Personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".
2. Kontrolluesi, "Europe Agency" sh.p.k. Tiranë, brenda një periudhe 10 (dhjetë) ditore nga dalja e këtij vendimi, të marrë masat për shkatërrimin e të dhënave personale të punonjësve, të grumbulluara pas procesit të intervistimeve, gjatë orarit të ushtrimit të detyrave të tjera në vazhdim.
3. Kontrolluesi, "Europe Agency" sh.p.k. Tiranë, ka detyrimin të njoftojë Zyrën e Komisionerit, mbi përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ky akt. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore, mund të jetë objekt hetimi në vazhdimësi.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 21.12.2016

